



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.03.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4639/15, për z. Muhamet Gashi – Këshilltar Politik i Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4639/15, për z. Muhamet Gashi – Këshilltar Politik i Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat N.B.SH. “Prishtina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

Zyrtari i lartë është njoftuar për situatën në të cilën ndodhet si dhe për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Gashi ka deklaruar se nuk e ka ditur se kjo situatë paraqet konflikt interesi meqenëse biznesi aktualisht është pasiv, mirëpo është zotuar se do të shmang konfliktin e interesit brenda afatit ligjor, duke caktuar një person të autorizuar për të administruar këtë biznes.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar biznesin privat N.B.SH. "Prishtina". Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

